

VENDIM
Nr. 531, datë 7.8.2012

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E CIKLIT FILLOR NË INSTITUCIONIN ARSIMOR
JOPUBLIK “SHKOLLA FRANCEZE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të ciklit fillor në institucionin arsimor jopublik “Shkolla Franceze e Tiranës”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha